

REPUBLIKA E MAQEDONISË  
РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

UNIVERSITETI “NËNË TEREZA” në SHKUP  
УНИВЕРЗИТЕТ „МАЈКА ТЕРЕЗА“ - СКОПЈЕ



**BULETINI**  
I  
UNIVERSITETIT “NËNË TEREZA” në SHKUP

**БИЛТЕН**  
НА  
УНИВЕРЗИТЕТОТ „МАЈКА ТЕРЕЗА“ - СКОПЈЕ

**Nr.12 / Бр.12**

**Shkup, 03.Prill 2018**  
**Скопје, 03 Април 2018**

**Botim i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup**  
**Издание на Универзитетот „Мајка Тереза“ - Скопје**

Redaktor i veprimtarisë botuese të UNT-së/ Уредник на издавачката дејност на УМТ:  
Prof.dr.Azis Pollozhani, u.d. rekor

Redaktor i Buletinit / Уредник на Билтенот:  
Prof.dr. Mustafa Ibrahim

Këshilli redaktues i Buletinit / Уредувачки одбор на Билтенот:  
Prof. dr. Rizvan Sulejmani  
Prof. dr. Zoran Trifunov  
Prof.dr. Mustafa Ibrahim

## **PËRMBAJTJA / СОДРЖИНА**

- 1. Propozim nga Fakulteti i Shkencave Sociale drejtuar Senatit për zgjedhjen e prof. Ferid MURAD për “Honoris Causa” nga UNT-ja.**

Duke marrë parasysh vendimin pozitiv të Këshillit Mësimor – Shkencor të Fakultetit të Shkencave Sociale të UNT-së, mbajtur më 23.02.2018 ku u ngrit iniciativa për shpalljen e nobelistit Ferid MURAD për Doktor Nderi në Universitetin tonë. Në emër të Komisionit të zgjedhur në përbërje:

1. Prof.dr. Murtezan Ismaili – kryetar,
2. Prof.dr. Azis Pollozhani,
3. Prof.dr. Rizvan Sulejmani
4. Prof.dr. Zoran Popovski
5. Prof.dr. Bekim Fetai

### **Senatit të UNT-së i P R O P O Z O J M Ë**

**Që të shqyrtojë dhe miratojë propozimin për zgjedhjen e prof. Ferid MURAD për “Honoris Causa” në UNT.**

Në bazë të dispozitave ekzistuese, përkatësisht respektimit të akteve normative dhe kritereve që kanë të bëjnë me zgjedhjen **Doktor Nderi, “Honoris Causa” të UNT-së**, me propozim të **Fakultetit të Shkencave Sociale pranë UNT-së**.

Të bindur se është e panevojshme dhe e tepërt, madje edhe jo modeste që me këtë rast të paraqitet referat të detajuar për një personalitet të shpërblyer me Çmimin Nobël. E shohim të udhës t’i rikujtojmë vetëm disa të dhëna, më tepër të natyrës informative rreth kandidatit të propozuar, duke patur para sysh se institucionet kompetente dhe meritore kanë shkruar referate dhe arsyetime voluminoze për kandidatin në fjalë me rastin e propozimit për shpërblimin Nobël.

Nobelisti Ferid Murad u lind më 14 shtator 1936, në Whiting të shtetit Indiana në SHBA.

Tani si punëtor shkencor i spikatur e me renome të lartë të një dijetari dhe edukatori, punon në “Department of Integrative Biology and Pharmacology, University of Texas Medical School – Houston”.

Me punën e tij vetëflijuese dhe me thellësinë e një shkencëtari të talentuar dr. Ferid Murad arriti rezultate të pakontestueshme në lëmin e Mjekësisë, Farmacisë, Kimisë dhe Biologjisë, ku me origjinalitetin e vet kontribuoi jo vetëm në përparimin por edhe në

zhvillimin e të menduarit shkencor si dhe në aplikimin e rezultateve shkencore në të mirë të mbarë njerëzimit.

Për suksesin e madh që ka arritur në lëmin e shkencës me karakter shumëdisiplinor, gjatë punës shumëvjeçare dr. Ferid Murad është nderuar me shumë diploma nderi, ka marrë shumë shpërblime dhe është anëtar i një varg shoqatash shkencore e profesionale të institucioneve dhe shteteve të ndryshme me renome e famë botërore.

Po përmendim vetëm disa nga diplomat dhe dekoratat me të cilat është nderuar dr. Ferid Murad, si: “Honoris Causa” nga Universiteti i Tiranës më 1999, Doktor Shkencash “Honoris Causa” nga Case Western Reserve University, Cleveland, Ohio, Maj, 2000; Doktor i shkencave “Honoris Causa” nga Thomas Jefferson University, Philadelphia, Pennsylvania, Qershor 2000 etj.

Dr. Ferid Muradi gjithashtu është fitues i disa dhjetëra shpërblimeve të ndryshme, nga të cilat mund të veçohen: Shpërblimi Nobël në Fiziologji – Mjekësi në vitin 1998; Shpërblimi i Akademisë Kombëtare të Shkencave të SHBA-ve në vitin 1997; i Akademisë së Shkencave të Nju Jorkut më 1975, Shpërblimi “Golden Plate Award” i Akademisë Amerikane e të Arriturave më 1999; është anëtar i Akademisë Amerikane të Shkencave dhe të Arteve (2000), anëtar i Akademisë së Shkencave të Maqedonisë, Shqipërisë etj. Dr. Ferid Murad është anëtar i disa shoqatave shkencore dhe profesionale amerikane nga lëmi i mjekësisë, farmacisë, biologjisë dhe kimisë.

Ka mbajtur një numër të madh të ligjëratave nëpër institucione prestigjioze në Amerikë dhe anëmbanë botës, është autor i shumë patentave dhe licencave amerikane.

Dr. Ferid Murad është autor i një numri të madh (mbi 450 ) publikimesh në formë punimesh, kapitujsh dhe librave të ndryshëm, si dhe një varg të gjerë (mbi 400) abstraktesh dhe prezantimesh të nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar.

Ky studiues i talentuar dhe i gjithanshëm , me origjinë shqiptare, nëpërmjet rezultateve të mëdha të arritura në shkencë, pa dyshim ka kontribuar jo vetëm në afirmimin dhe ngritjen e autoritetit të kombit dhe qenies shqiptare por edhe njerëzimit në hapësira edhe më të gjera botërore, kontributi i të cilit në këso rastesh duhet të vlerësohet dhe të respektohet.

Në rastin tonë besojmë se do të jetë një akt shumë afirmativ dhe shumë i vlefshëm për aspiratat zhvillimore të këtij Institucioni të arsimit dhe shkencës me interes më të gjerë.

Nisur nga fakti se kemi të bëjmë me një personalitet të kalibrit me përmasa botërore në lëmin e shkencës bashkëkohore besoj se duhet të kemi nderin dhe kënaqësinë e veçantë që t’i propozojmë SENATIT të UNT-së që të miratojë procedurën për shpalljen e nobelistit Ferid Murad doktor shkencash, “Honoris Causa” pranë këtij universiteti.

Prof.emeritus Murtezan Ismaili – kryetar,

Prof.dr. Azis Pollozhani,  
Prof.dr. Rizvan Sulejmani  
Prof.dr. Zoran Popovski  
Prof.dr. Bekim Fetai

Shkup, 03.04.2018